




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY
OF SHTIME

Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Mayors office

Data/Datum/Date:	05. 7.2022
Nr.Br.No:	02/300
Për/ Za/To:	Kuvendin e Komunës Shtime, z. Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu
Nga/Od/From:	Zyra për Informim
Lënda/Predmet/Subject:	INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KKSBB-në

Bazuar në nenin 58 pikat (g, h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076, si dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB dhe U.A-03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Kryetari i Komunës së Shtimes paraqet para Kuvendit të Komunës këtë:

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KKSBB-në

Parimi kryesor i KKSBB-së gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore ka qenë kryesisht i përqendruar nga aktivitete për çështje të sigurisë, në bashkëpunim me policinë dhe qytetaret, si dhe me organizatat tjera të sigurisë, KLSP-të, EVSB-të dhe përfaqësuesit e Shoqërisë civile, për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve, KKSBB-ja ka pasur si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e komunës së Shtimes.

Më 28 mars 2022

Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të KKSBB-së, pas miratimit në Kuvendin e Komunës në Mbledhjen e II (dytë) të rregullt është aprovuar me këtë përbërje:

1. Kryetari i Komunës, z. Qemajl Aliu ; Kryesues i KKSBB-së
2. Përfaqësues i FSK-së Gëzim Morina
3. Komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime, Fatmir Limani
4. Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime, z. Skender Baftiu
5. Drejtori i Drejtorisë për Arsim, z. Lulzim Sahiti
6. Shefi i Zyrës për Kthim dhe Komunitete (ZKKK), z. Ibrahim Demiri;
7. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, z. Bajram Ilazi
8. Përfaqësuesi i Komitetit Ashkali, z. Shefki Osmani;
9. Koordinator për të drejtat e njeriut dhe Barazi Gjinore Reshat Gashi

10. Përfaqësuesi i Komunitetit Rom, z. Arton Demiri;
11. Përgjegjësi për Siguri dhe Emergjencë, z. Skender Dauti
12. Përfaqësuesi i EVSB-së, z. Muhadin Halili;
13. Përfaqësuesi i OJQ "Vizionida", z. Zhaneta Demiri;
14. Përfaqësuesi i Prindërve në Shkollë, z. Basri Hyseni
15. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike, Albert Ramadani

Në komunën tona kemi arritur t'i mbajmë vetëm dy takime me anëtarët e KKSB-së:

1. Mbledhja e parë është thirrë më datë 13 maj 2022 dhe është mbajtur me datë **20. 05. 2022 (e premte), ora 15:00**, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Në këtë takim fillimisht u njoftuan anëtarët e rinj të KKSB dhe u diskutua për Sigurinë e Përgjithshme në Komunën e Shtimes dhe Të Ndryshme...



Foto gjatë Mbledhjes së Parë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja e -I- (e parë) për vitin 2022 e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Në mbledhjen e parë të KKSB-së të pranishëm ishin shumica e anëtarëve, përfaqësues të KLSP-së, përfaqësues i stacionit të Policisë së Kosovës në Shtime, drejtorë, zyrtarë komunalë dhe këshilltarë komunal.

Mbledhjen e udhëheqi kryetari i Komunës së Shtimes, z.Qemajl Aliu, njehërit kryesues i KKSB-së, i uroi mirëseardhje anëtarëve të KKSB-së, foli për qështjen e sigurisë dhe u zotua për mbështetjen në mbarëvajtjen e punës së KKSB-së për vitin 2022.

Anëtarët e KKSB-së ngriten një sërë qështjesh ku prekin direkt sigurinë e qytetarëve të komunës sonë. Shefi i Operativës në Stacionin Policor të Shtimes, Nexhmedin Ahmeti raportoi para të pranishmëve ku e cilësoi gjendjen e sigurisë të qetë dhe stabile.

Në fund të takimit, kryetari Aliu i falënderoi për pjesëmarrjen anëtarët e KKBS-së duke uruar bashkëpunim të frytshëm e rezultate pozitive nga ky mekanizëm mjaft i rëndësishëm për rrjedhat e sigurisë në nivel lokal.

2. Mbledhja e II (e dytë) e KKSB-së është thirrë më, 16 qershor dhe u mbajt në Sallën e Kuvendit të Komunës më, 28 qershor 2022 në ora 15:00.




Foto gjatë Mbledhjes së Dytë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

U mbajt mbledhja e dytë e KKSB-së për vitin 2022.

Mbledhjen e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Adnan Ademi ngase kryetari i Komunës së Shtimes, z.Qemajl Aliu ishte në një vizitë zyrtare.

Kryesuesi Ademi i uroi mirëseardhje anëtarëve të KKSB-së, pasi konstatoi korumin e mjaftueshëm para të pranishmëve prezantoi rendin e ditës: Siguria e përgjithshme në komunën e Shtimes dhe Të ndryshme. Shefi i Operativës në Stacionin Policor të Shtimes, Nexhmedin Ahmeti raportoi në detaje për sigurinë dhe gjendjen në qytetin e Shtimes, aksidentet në komunikacion etj. Ai e cilësoi gjendjen e sigurisë të qetë dhe stabile.

Të pranishëm në këtë Mbledhje të rregullt të KKSB-së edhe përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, përfaqësues nga OJQ Vizionida etj. Gjithashtu edhe anëtarët tjerë të KKSB-së e KLSB ngriten shqetësimet që kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve në komunën e Shtimes : Siguria e nxënësve në shkolla, rreziku nga qentë endacak, pastaj së bashku apeluan për kujdes të shtuar për shkak të zjarreve në sezonën që po hymë.

Objektivat e KKSB-së janë formuluar për të dhënë përgjigje ndaj çështjeve të sigurisë që duhet adresuar.

Sipas Udhëzimit Administrativ, KKSB ka 5 objektiva kryesore:

1. “Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal;
2. Identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike;
3. Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale;
4. Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi
5. Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështjet e tjera që lidhen me kualitetin e jetës.

Detyrat kryesore të KKSB-së, ndër të tjera janë:

- 1- Përgatitja e Planit vjetor të Punës
- 2- Identifikimi i problemeve dhe rekomandimi i planeve të veprimit
- 3- Bashkëpunimi me policinë
- 4- Bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike
- 5- Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi
- 6- Paraqitja e kërkesave në Kuvendin e Komunës për financimin e projekteve për siguri në bashkësi
- 7- Paraqitja e kërkesave në organizata të ndryshme për financimin e projekteve për siguri në bashkësi;
- 8- Të ftoj në takimet e KKSB-së përfaqësuesit e MPB-së – DSB.
- 9- Të ftoj në takimet e KKSB-së përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, medieve dhe shoqërisë civile
- 10- Të kërkoj nga policia përgjigje për rastet që kanë rëndësi në sigurinë publike.
- 11- Mbajtjen e takimeve të rregullta të KKSB-së.

Shtime,
4 korrik 2022

Kryetari i Komunës, Qemajl Aliu
